



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:067082

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05388843

KPPP.nr.2336/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbarimore të kreditorit “NLB Bank” me seli në Prishtinë ndaj debitorit T.F. Sh.P.K., përfaqësuar nga M.K., me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e personit të tretë R.K., kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.540/18 të datave 19.04.2019 dhe 26.04.2019, të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri, jashtë seancës me datë 28.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i paplotësuar prapësimi-parashtresa e personit të tretë R.K. i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.540/18 të datave 19 dhe 26.04.2019 të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri.
- II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.540/2018 të datave 19 dhe 26.04.2019 të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.611/2019 të datës 26.12.2019, e ka hedh si të pasafatshëm prapësimin e personit të tretë R.K., i paraqitur kundër urdhrit përmbarimor P.nr.540/18 të datave 19 dhe 26.04.2019 të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë personit i tretë R.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë,

këtë ankesë të aprovojë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, me aktvendim K.DH.SH.II.nr.75/22 të datës 14.10.2022 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e palës së tretë, R.K., ashtu që ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.611/2019 i datës 26.12.2019, dhe lëndën e ka kthyer në Gjykatën Komerciale-Dhomës së Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosjes.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar sipas udhëzimeve të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, me konkluzion e datës 13 tetor 2023, ka kërkuar nga R.K., si palë e tretë në këtë rast, të sqaroj cilin mjet juridik e ka përdorur dhe cilin vendim apo urdhër është subjekti i ankimimit në këtë rast të veçantë.

Sipas dokumenteve të paraqitura nga R.K. në parashtrësën e datës 30 tetor 2023, ajo ka specifikuar se mjeti juridik i përdorur daton nga 6 gusht 2022 dhe është kundër urdhrit përmbarimor P.nr.306/14 të datës 20 korrik, të lëshuar nga përmbaruesit privat Atip Mustafa.

Kjo gjykatë, me datë 12.12.2023 ka marr konkluzion KPPP.nr.2326/2023, me të cilin ka kërkuar nga personi i tretë që të bëjë plotësimin e parashtrësës të datës 30.10.2023 duke bashkangjitur mjetin juridik, përkatësisht prapësimin e cekur në këtë parashtrësë, duke cekur saktë numrin e urdhrit përmbarimor, datën dhe emrin e Përmbaruesit Privat.

Kjo gjykatë ka tentuar që konkluzionin KPPP.nr.2336/2022 të datës 12.12.2023, t'ia dorëzoj personit të tretë në adresën rr.“Mulla Ilaz Broja” nr.2, Mitrovicë, por nga fletë kthesa që gjendet në shkresa të lëndës rezulton se Posta e Kosovës ka tentuar disa herë nga data 18.12.2023 deri me 20.12.2023 që të dorëzoj plikon me konkluzion mirëpo nuk ka pasur sukses për shkak se ka qenë dera e mbyllur në adresën e personit të tretë dhe i la lajmërimin në sportelin e Postës së Kosovës.

Meqë Gjykata nuk kishte arritur që t'ia dorëzoj personit të tretë konkluzionin, për shkak se dera ishte mbyllur dhe i njëjti nuk e kishte njoftuar gjykatën, për ndonjë adresë tjetër, gjykata me datë 15.01.2024 ka marr aktvendim që dorëzimi i të gjitha shkresave dhe parashtrësive ndaj personit të tretë, R.K., do të bëhet me publikimin e tyre në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, dhe se kjo mënyrë e dorëzimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i tij të njoftoj Gjykatën për

adresën e re. Ky aktvendim së bashku me Konkluzionin KPPP.nr.2336/2022 të datës 12.12.2023 u afishua me datë 15.01.2024, ndërsa u tërhoq pas kalimit të afat prej 7 (shtatë) ditë nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

Sipas fakteve të lartcekura, në bazë të nenit 116 të LPK-së rezulton se Debitori e ka pranuar konkluzionin cekur, të publikuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, pas kalimit të 7 (shtatë) ditëve nga dita e afishimit të shkesave në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Në lidhje me këtë, duke u bazuar në nenin 179.2 të LPK-së i cili përcakton se *“Po që se ankuesi brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë”* në ndërlidhje me nenin 73 para.3 të LPP-së i cili parasheh se *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke hedhur prapësimin-parashtresën si jo të plotësuar, në mungesë të plotësimit të tij nga personit i tretë brenda afatit të përcaktuar sipas konkluzionit KPPP.nr.2336/2022 të datës 12.12.2023.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 para. 3 të LPP-së dhe nenit 13 para.1 nënpara 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2336/22, datë 28.02.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.